

VENDIM
Nr. 170, datë 15.5.2023

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 55, DATË 22.2.2021, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘ARIS ALBANIA’ SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, NGA HEC ‘GURI I ZI’ ME KAPACITET TË INSTALUAR 1719 kw, HEC ‘DAZNJANË’ ME KAPACITET TË INSTALUAR 1518 kw DHE HEC ‘SHËLLI’ ME KAPACITET TË INSTALUAR 1518 kw, ME KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR 4755 kw”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.5.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1327/2 prot., datë 12.5.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 55 , datë 22.2.2021, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Aris Albania’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Guri i Zi’ me kapacitet të instaluar 1719 kw, HEC ‘Daznjanë’ me kapacitet të instaluar 1518 kw dhe HEC ‘Shëlli’ me kapacitet të instaluar 1518 kw, me kapacitet total të instaluar 4755 kw’, të ndryshuar”.

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 55, datë 22.2.2021, të ndryshuar me vendimin e Bordit nr. 197, datë 3.8.2022, ka vendosur:

1. Të licencojë shoqërinë “Aris Albania” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Guri i Zi” me kapacitet të instaluar 1719 kw, HEC “Daznjanë” me kapacitet të instaluar 1518 kw, dhe HEC “Shëlli” me kapacitet të instaluar 1518 kw, me kapacitet total të instaluar 4755 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Në përfundim të afatit të lejeve të shfrytëzimit të burimit ujor (data e përfundimit 27.4.2022), me nr. 99 prot., datë 8.5.2017, për HEC “Daznjanë”, nr. 100 prot., datë 8.5.2017, për HEC “Guri i Zi” dhe nr. 101 prot., datë 8.5.2017 për HEC “Shëlli”, shoqëria “Aris Albania” sh.p.k. t’i paraqesë në ERE me afate të rinovuara jo më vonë se 1 muaj nga nënshkrimi i rinovimit.

3. Në përfundim të afatit të kontratave respektive të qirasë me Bashkinë Mat (data e përfundimit 15.7.2022), shoqëria “Aris Albania” sh.p.k. t’i paraqesë në ERE me afate të rinovuara, jo më vonë se 1 (një) muaj nga nënshkrimi i rinovimit.

- Në lidhje me kushtin e vendosur në pikën 2 të këtij vendimi, rezulton se shoqëria “Aris Albania” sh.p.k. ka depozituar të rinovuara lejet për përdorimin e burimit ujor për HEC “Guri i Zi” (me afat deri më 7.11.2027), “Daznjanë” (me afat deri më 4.4.2028) dhe “Shëlli” (me afat deri më 4.4.2028).

- Duke qenë se afati i vlefshmërisë së këtyre lejeve nuk mbulon të gjithë periudhën e licencimit, vlerësohet që të ndryshohet pika 2 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 55/2021, të ndryshuar, duke i lënë detyrë shoqërisë që të depozitojë në ERE lejet e rinovuara të përdorimit të burimeve ujore brenda afatit të fundit të vlefshmërisë së tyre.

- Në lidhje me kushtin e vendosur në pikën 3 të vendimit të Bordit nr. 55/2021, të ndryshuar, shoqëria ka depozituar kontratat e rinovuara të qirasë me Bashkinë Mat për HEC “Guri i Zi”, “Shëlli” dhe “Daznjanë”, me afat vlefshmërie 10 (dhjetë) vjet, deri në datën 23.8.2032, me të drejtë rinovimi.

- Sa konstatuar, ky afat nuk mbulon të gjithë afatin e vlefshmërisë së licencës së shoqërisë, ndaj vlerësohet që pika 3 e vendimit të Bordit nr. 55/2021, të ndryshuar, të ndryshohet duke i lënë detyrë shoqërisë që të depozitojë në ERE kontratat e qirasë të rinovuara me Bashkinë Mat, jo më vonë se data 24.8.2032, ose çdo dokument tjetër që rregullon pronësinë në zonën ku shtrihet projekti.

- Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e ndryshimit të një akti, me nismën e vet organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 55, datë 22.2.2021, të ndryshuar, ndryshon dhe bëhet:

“2. Shoqëria “Aris Albania” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE lejet e përdorimit të burimit ujor të rinovuara brenda afatit të fundit të vlefshmërisë së tyre, përkatësisht:

- a) brenda datës 7.11.2027, lejen e rinovuar për HEC “Guri i Zi”;
- b) brenda datës 4.4.2028, lejen e rinovuar për HEC “Daznjanë”;
- c) brenda datës 4.4.2028, lejen e rinovuar për HEC “Shëlli”.”.

2. Pika 3 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 55, datë 22.2.2021, të ndryshuar, ndryshon dhe bëhet:

“3. Shoqëria “Aris Albania” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE kontratat e qirasë të rinovuara me Bashkinë Mat, jo më vonë se data 24.8.2032, ose çdo dokument tjetër që rregullon pronësinë në zonën ku shtrihet projekti.”.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Aris Albania” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti